

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 8 numër 6 qershor 2006

Data e botimit 07.07.2006

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.46, datë 28.06.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2006""	5
2. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 1, Janar 2006	24
3. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 2, Shkurt 2006	24
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 3, Shkurt 2006	24
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 4, Maj 2006	25
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 8, Numër 5, Maj 2006	25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.46, datë 28.06.2006

PËR

MIRATIMIN E "RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR MUAJIN MAJ TË
VITIT 2006"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "ç" të ligjit nr. 8269,
datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e
Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së
Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Raportin e Politikës Monetare për muajin maj të vitit
2006", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit
Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

RAPORTI MUJOR I POLITIKES MONETARE, MAJ 2006

PËRMBLEDHJE

ZHVILLIMET NË INFLACION

- Norma vjetore e inflacionit u rrit në 3.1 për qind në muajin maj 2006. Inflacioni i matur nga IÇK-ja tregoi një rritje të theksuar nga vlera 2.3 për qind që është mesatarja e tij në katër muajt e parë të vitit. Shifra prej 3.1 për qind e inflacionit shënon rritjen e katërt të njëpasnjëshme të tij. Në muajin janar 2006, inflacioni rezultoi 1.3 për qind.
- Ulja sezonale e çmimeve të ushqimeve ishte më e vogël sesa pritej, ndoshta për shkak të uljes së ofertës me produkte vendore. Norma mujore e inflacionit prej -0.4 për qind shënoi vlerën më të ulët për periudhën në konsideratë në pesë vitet e fundit.
- Rritja e inflacionit vjetor reflekton kontributin e çmimeve të produkteve bujqësore dhe të naftës. Grupet "Ushqim dhe pije joalkolike" dhe "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" shpjegojnë 82 për qind të inflacionit vjetor.

TREGUESIT MONETARË

- Zgjerimi monetar në ekonomi vazhdon me ritme relativisht më të ulëta sesa në vitet e kaluara, për shkak të mungesës së huamarrjes nga sektori publik. Rritja e ofertës monetare në vlerën 10 për qind është në përputhje me trendet historike. Paraja jashtë bankave dhe agregati M2 kanë ndjekur trendet e tyre, duke çuar në ruajtjen e një strukture të qëndrueshme kohore dhe valutore të ofertës monetare.
- Në muajt e fundit, rritja e ofertës së parasë në terma nominalë është shoqëruar me rritjen e kreditimit të sektorit privat. Teprica e kredisë për sektorin privat arriti në 140.0 miliardë lekë në muajin prill 2006, duke ruajtur të njëjtën rritje mujore prej 5.5 miliardë lekësh, si në muajin mars. Kredia për sektorin privat është rritur me 18.1 miliardë lekë në katër muajt e parë të vitit 2006, krahasuar me 14.0 miliardë lekë për të njëjtën periudhë një vit më parë. Ndërkohë, në programin monetar të Bankës së Shqipërisë për gjithë vitin 2006, rritja e kredisë është parashikuar në vlerën 63.3 miliardë lekë.
- Në muajin prill, qeveria ka vazhduar emetimin e notave dy dhe trevjeçare përkatësisht për shumat 0.5 miliardë lekë dhe 1.5 miliardë lekë. Niveli i bonove të thesarit të emetuara këtë muaj ishte 3.4 miliardë lekë më i ulët sesa maturimi i tyre.
- Kushtet e likuiditetit në sistemin bankar nuk kanë ndryshuar, krahasuar me një muaj më parë. Teprica e likuiditetit ka qëndruar në nivele të larta, duke nxitur uljen e mëtejshme të normave

të interesit në lekë. Në fund të muajit maj, *yield*-i i bonove të thesarit me maturitet 12-mujor zbriti në 5.72 për qind nga 5.83 për qind, në fund të muajit prill. Mesatarisht, inflacioni llogaritet 2.2 për qind e kthimit nominal nga interesat në lekë, duke bërë që interesi real i depozitave në lekë të jetë rreth vlerës 2.0 për qind.

- Rritjet e interesit bazë për euron dhe dollarin amerikan, gjatë vitit 2006 nga bankat qendrore respektive, kanë çuar në reduktimin e *spread*-it midis interesit të depozitave në lekë dhe atij të depozitave në valutë.
- Ecuria e kursit të këmbimit ka reflektuar zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Leku është forcuar kundrejt dollarit amerikan ndërsa ka qenë i qëndrueshëm kundrejt euros. Në terma nominalë efektivë, leku është forcuar me 1.5 për qind krahasuar me një vit më parë. Në fund të muajit maj, kursi i këmbimit shënoi 95.84 lek/usd dhe 123.3 lek/euro.

I. INFLACIONI NË MAJ


Rritja vjetore në inflacionin total të muajit maj 2006 ishte 3.1 për qind, duke shfaqur një rritje prej 0.8 pikë përqindjeje nga muaji i mëparshëm. Norma mesatare vjetore e inflacionit për dy muajt e fundit ishte 2.2 për qind. Inflacioni vjetor në muajin maj të këtij viti reflektoi kontributin e çmimeve bujqësore dhe të naftës. Norma e inflacionit mujor prej -0.4 për qind ishte rënia më e ulët për periudhën e referencës. Efekti i reduktuar sezonal reflekton në përgjithësi mungesën e ofertës së prodhimit të brendshëm bujqësor.

Në muajin maj të këtij viti parashikimi i inflacionit prej +2.5 për qind u bazua në efektin sezonal të uljes së çmimeve të "Ushqim dhe pije joalkolike", i cili zakonisht ka variuar në nivele shumë të ulëta negative, si rezultat i rritjes së prodhimit veror për produktet e sezonit. Ndërkohë, ulja e çmimeve ushqimore nuk u vu re këtë vit si pasojë e gjendjes së përkeqësuar të motit.

I.1 ECURIA E INFLACIONIT SIPAS GRUPEVE


Indeksi i çmimeve të konsumit u ndikua nga kontributi pozitiv i grupeve "Ushqim dhe pije joalkolike" dhe "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji", që janë përgjegjëse për 82 për qind të inflacionit vjetor.

Grafik 1. Ecuria e inflacionit vjetor (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Kontributi i shportës së IÇK-së në grupet kryesore (në pikë përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Çmimet e ushqimeve u rritën me një normë vjetore prej 3.7 për qind gjatë muajit maj të këtij viti, duke kontribuar me 50 për qind në inflacionin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Ndryshimi mujor ishte -1.5 për qind, që është niveli më i lartë negativ në krahasim me 4 vitet e kaluara. Kjo ecuri u ndikua nga rritja e çmimeve bujqësore dhe nga rritja e teçimit të inflacionit të importuar në çmimet vendase të konsumatorit. Inflacioni i importuar u ndikua nga zbutja e vlerësimit të lekut kundrejt euros.

Tabelë 1. Inflacioni i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe peshat e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor '05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor '06	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor Itali ¹ '06	Inflacioni vjetor Greqi ² '06
Mars	-1.7	-0.7	0.4	0.2	1.0	2.1
Prill	-2.2	-1	2.5	1	0.9	3.8
Maj	-0.7	-0.3	3.7	1.5		2.9

Burimi: INSTAT.

Inflacioni vjetor i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" ishte 3.8 për qind. Ashtu si në muajt e kaluar, kontributin më të madh e dha nëngrupi "Renta e imputuar" (përfaqëson 90 për qind të inflacionit vjetor të këtij grupi).


Tabelë 2. Inflacioni i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" dhe peshat e tij në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor '05	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor '06	Kontributi (pp)
Mars	9.8	2.4	3.5	0.9
Prill	7.2	1.8	3.2	0.8
Maj	7.2	1.8	3.8	1

Burimi: INSTAT.

Rritja vjetore e çmimeve të grupit "Transport" ishte 4.8 për qind dhe ajo mujore ishte 0.9 për qind. Pavarësisht nga vlerësimi i lekut kundrejt dollarit dhe efektit konsequent të amortizimit, rritja e çmimeve të naftës jashtë vendit u transmetua në çmimet e brendshme, duke rezultuar në një rritje vjetore me 1.6 për qind të inflacionit në nëngrupin "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit" (nafta është artikulli më i rëndësishëm i këtij nëngrupi).

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore në shportën e IÇK-së (në pikë përqindjeje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Inflacioni vjetor i grupeve të tjera nuk ka ndryshuar shumë në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë, duke kontribuar me 0.3 pikë përqindjeje tek çmimet e konsumatorit.

1.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT


Presionet nga ana e kërkesës në ekonomi mbetën relativisht joekzistente në muajin maj të vitit 2006. Zhvillimi pozitiv i treguesve monetarë dhe fiskalë ka balancuar presionet inflacioniste, të cilat kanë ardhur nga ambientet e jashtme

dhe nga zhvillimet negative të ofertës. Çmimet e larta të naftës, oferta e reduktuar e prodhimeve bujqësore dhe trendi rënës i vlerësimit të lekut kundrejt euros, janë faktorët më të rëndësishëm, të cilët rrezikojnë çmimet në të ardhmen. Ata vijnë në përgjithësi nga ana e ofertës së ekonomisë.

POLITIKA MONETARE

Trendi rënës i rritjes vjetore të M3 dhe i parasë jashtë bankave vazhdoi në maj të këtij viti. Ka vazhduar rritja e kredidhënies nga muaji i kaluar, por ritmet në rënie të rritjes së saj sugjerojnë presione të ulëta në inflacion.

Grafik 4. Zhvillimet e tregesve monetare.




POLITIKA FISKALE

Gjatë pesë muajve të parë të vitit 2006, zbatimi i buxhetit u realizua më mirë se parashikohej. Rritjet e të ardhurave buxhetore dhe rënie të deficitit fiskal tregojnë për një qëndrim të kufizuar të politikës fiskale për këtë periudhë. Megjithatë, shpenzimet buxhetore planifikohen të rriten në muajt e ardhshëm. Ky zhvillim sigurisht që do të rrisë presionet nga ana e kërkesës në ekonomi.

Rritja e suficitit buxhetor ka ndikuar në kërkesën e ulët për para. Yield-i i bonove 12-mujore, i cili ka patur një trend rënës që nga shtatori i vitit të kaluar, ka arritur në nivelin 5.8 për qind në muajin maj të këtij viti.

Grafik 5. Zhvillimet në shpenzimet buxhetore.



KURSI I KËMBIMIT DHE INFLACIONI I IMPORTUAR

Norma mesatare e këmbimit të lekut u vlerësua kundrejt dollarit në maj të këtij viti, duke arritur një vlerësim vjetor prej 2.1 për qind dhe një vlerësim mujor prej 4 për qind. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros ishte 123 lek/euro në maj të këtij viti, i cili përfaqëson një vlerësim vjetor prej 1.4 për qind, por një zhvlerësim mujor prej 0.1 për qind.

E rëndësishme nga pikëpamja e inflacionit në vend, ishte fakti se vlerësimi i lekut kundrejt euros është dobësuar që nga marsi i këtij viti dhe prandaj, ndryshe nga muajt e kaluar, ecuria e kursit të këmbimit ka dështuar në reduktimin e impaktit të çmimeve të larta të produkteve ushqimore të importit.

Tabelë 3. Inflacioni vjetor i vendeve partnere dhe ndryshimet në kursin e këmbimit (në përqindje) për vitin 2006.


	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj
Greqi ³	3.2	3.2	3.3	3.3	3.1
Itali ⁴	2.2	2.1	2.1	2.2	2.2
Lek/Euro	-2.5	-3.3	-2.9	-2.5	-1.4

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

ÇMIMET E PRODHIMIT

Gjatë muajit mars 2006 indeksi i çmimeve të prodhimit rezultoi me rënie, por transmetimi në çmimet e konsumatorit ka qenë i pandjeshëm deri tani. Rritja e shpejtë në periudhën e referuar u regjistrua në nëngrupin e industrisë nxjerrëse – nxjerrja e prodhimit energjitik dhe në nëngrupin e përpunimit të ushqimit dhe pijeve, të cilat sjellin rritje presioni nga kosto.

Grafik 6. Ndryshimet vjetore të IÇK dhe IÇP.



ÇMIMET E NAFTËS




Rritja në çmimet e naftës vazhdoi në fillim të majit të këtij viti, duke rezultuar në një normë rritjeje vjetore prej 36.5 për qind, e cila u përcoll në rritjen e inflacionit të çmimeve të konsumit për grupin "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit". Rritja vjetore në çmimin vendas të naftës vazhdoi edhe në muajin maj të këtij viti, duke u ndikuar vetëm nga rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare dhe jo nga ecuria e kursit të këmbimit (leku u vlerësua fuqimisht kundrejt dollarit).

II. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET


Zgjerimi monetar në ekonomi vazhdon me ritme më të ulëta sesa një vit më parë. Norma e rritjes së ofertës së parasë prej 10.0 për qind është në përputhje me trendin historik dhe reflekton mungesën e huamarrjes nga sektori publik. Paraja jashtë bankave dhe agregati M2 kanë ndjekur të njëjtin trend, duke çuar në ruajtjen e qëndrueshme të strukturës kohore dhe valutore të ofertës së parasë.

Në terma realë, zgjerimi i ofertës së parasë është ngadalësuar me ritme më të theksuara. Aktualisht, norma e rritjes së këtij treguesi është 6.5 për qind. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2005, oferta e parasë u rrit me 15.0 për qind në terma realë.

Në terma nominalë, rritja e ofertës së parasë është shoqëruar me kreditimin e sektorit privat. Ndërkohë, kontributi neto i sektorit publik në rritjen e agregatit M3 është negativ. Fakti që bilanci i qeverisë ka rezultuar me suficit, nuk ka ndikuar drejtpërsëdrejti në injektimin e parasë në ekonomi, por ka siguruar likuiditet në sistemin bankar. Kjo ka çuar në reduktimin e mëtejshëm të normave të interesit të bonove të thesarit.



Grafik 11. Raporti i depozitave në lekë ndaj M3 dhe interesi mesatar real i lekut (shkalla djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat nominale të interesit për depozitat kanë rënë lehtë. Në përgjithësi, norma reale e interesit për depozitat në lekë është ndikuar nga ecuria e inflacionit.

Pavarësisht luhatjeve mujore të normës së inflacionit, mesatarisht inflacioni gërryen 2.2 për qind të kthimit nga interesi, duke bërë që norma reale e interesit për depozitat bankare në lekë të llogaritet rreth 2.0 për qind.

Tabelë 4. Agregatët monetarë (në milionë lekë)⁶.


	Prill	Ndryshime tremujore		Ndryshime vjetore	
	2006	mln lekë	për qind	mln lekë	për qind
Paraaja jashtë bankave	138.2	0.9	0.7	7.6	5.8
Baza monetare	190.6	4.3	2.3	16.5	9.5
M1	218.9	1.6	0.7	46.3	26.8
M2	424.3	2.9	0.7	25.8	6.5
M3	584.1	3.8	0.6	58.1	11.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDIA PËR EKONOMINË

Në muajin prill 2006 teprica e kredisë arriti në 140.0 miliardë lekë, duke treguar të njëjtën rritje mujore prej 5.5 miliardë lekësh si në muajin mars. Norma vjetore e rritjes së kredisë ka zbritur në 66.8 për qind nga 68.0 për qind në muajin mars.

Grafik 12. Raporti i kredisë ndaj PBB-së dhe M3 (shkalla majtas) dhe norma vjetore e rritjes së kredisë (shkalla djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa që zë kredia për ekonominë ndaj ofertës së parasë u rrit në 24.0 për qind në muajin prill. Kredia e re e akorduar në këtë muaj llogaritet 12.7 miliardë lekë ose 35.0 për qind më shumë se një vit më parë.

Rritja vjetore e kredisë në lekë tregon një ulje të mëtijshme në 114.5 për qind krahasuar me 117.5 për qind në muajin mars. Rënia e konsiderueshme e normës vjetore të kredisë në lekë për individët, është kontributi kryesor i ecurisë së kredisë totale në lekë.

Megjithatë, pjesa që zë kredia në lekë në portofolin total të kredisë u rrit në 26.3 për qind.

Grafik 13. Rritja vjetore e tepricës së kredisë.



	2002	2003	2005				2006	
			T1	T2	T3	T4	Mars	Prill
Teprica e kredisë (në miliardë lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	121.9	134.6	140.0
Kredia për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.6	31.9	31.7
Kredia për bizneset	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.4	68.1	68.3
Kredia në lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	25.5	26.0	26.3
Kredia në valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	74.5	74.0	73.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Tabelë 5. Struktura e tepricës së kredisë (në përqindje ndaj totalit).

MJETET VALUTORE NETO


Mjetet valutore neto të sistemit bankar u rritën me 44.3 milionë usd në muajin prill. Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë u rritën me 40.0 milionë usd këtë muaj, si pasojë e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor dhe e efektit të kursit të këmbimit (forcimit prej 4.0 për qind të euros kundrejt dollarit amerikan).

Rezervat valutore neto të bankave tregtare janë ulur me 1.4 milionë usd, duke ndikuar negativisht mjetet valutore të sistemit bankar. Ky ndryshim u shkaktua nga ecuria e detyrimeve valutore (hua dhe depozita të jorezidentëve), të cilat vazhduan të rriten gjatë muajit, duke ndikuar negativisht nivelin neto të rezervave valutore.


Grafik 14. Mjetet valutore neto të sistemit bankar (në milionë usd).



Grafik 15. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Grafik 16. Spread-i midis interesave të depozitave në lekë dhe atyre në valutë.



KËRKESA E QEVERISË PËR PARA


Zhvillimet në llogaritë fiskale në muajin prill ruajtën të njëjtën prirje si në muajt paraardhës të vitit 2006. Qeveria ka rritur bilancin pozitiv fiskal në 7.1 miliardë lekë, duke ulur më tej kërkesën e saj për para. Financimi i brendshëm llogaritet në vlera negative 3.1 miliardë lekë, ndërsa depozita e qeverisë arriti në rreth 4.0 miliardë lekë.

Gjatë këtij muaji vazhdoi emetimi i notave dy dhe trevjeçare të qeverisë, përkatësisht për shumat 0.5 dhe 1.5 miliardë lekë. Niveli i bonove të thesarit të emetuara në treg ishte më i vogël sesa shuma e maturuar, duke dhënë një efekt neto negativ prej 3.4 miliardë lekësh. Në muajin prill, repot e anasjellta të organizuara nga qeveria u rritën me 2.5 miliardë lekë.

TREGU I PARASË DHE NORMAT E INTERESIT

Gjatë periudhës prill-maj 2006 sistemi bankar ka demonstruar të njëjtat kushte likuiditeti si në muajin mars. Teprica e likuiditetit ka qenë në nivele të larta⁷, duke nxitur uljen e mëtejshme të normave të interesit në lekë. Ndryshimet në normën bazë të interesit për euron dhe dollarin amerikan kanë ngushtuar diferencën midis interesave të depozitave në lekë dhe atyre në valutë.

Grafik 17. Interesat në tregun ndërbankar dhe normat e interesit të Bankës së Shqipërisë.



Tregu ndërbankar është karakterizuar nga stabiliteti i normave të interesit dhe nga zvogëlimi i *spread*-it midis kostos së huamarrjes njëditore dhe asaj shtatëditore.

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar këtë ecuri përmendim stabilitetin e kushteve të tregut, korridorin simetrik të lehtësive të ofruara nga Banka e Shqipërisë⁹, kushtet e likuiditetit në sistem dhe rritjen e konkurrencës në sistemin bankar. Rritja e mundshme e kërkesës për likuiditet në gjysmën e dytë të vitit, mund të çojë në luhatjen e normave të interesit në tregun ndërbankar.

Me përjashtim të instrumenteve afatshkurtra (në depozita e bono thesari) dhe kredisë afatgjatë (mbi 3 vjet), në të gjitha segmentet e tregut është vënë re ulje e normave të interesit në lekë¹⁰. Bilanci me suficit i llogarisë së qeverisë, kushtet në tepricë likuiditeti, inflacioni i qëndrueshëm, stabiliteti në tregun financiar, janë disa nga faktorët me ndikim pozitiv në trendin rënës të normave të interesit.


Ulja e interesave të kredisë në lekë në muajin prill ka ngushtuar diferencën midis interesit të kredisë në lekë me atë në valutë. Megjithatë, duke marrë në konsideratë rrezikun e kredisë, diferenca lekë-valutë mbetet tepër më e lartë në rastin e kredisë sesa në atë të depozitave. Lëvizjet e interesave në muajin prill sollën dhe ngushtimin e diferencës midis interesave të depozitave me ato të kredive si në lekë ashtu dhe në valutë, duke shënuar një zhvillim pozitiv për stabilitetin e tregjeve.

Tabelë 6. Diferenca e normave të interesit të kredive me ato të depozitave në sistemin bankar.

	Mars 2006	Prill 2006
		<i>Spread-i në lekë</i>
6-mujor	8.73 %	7.37 %
12-mujor	8.58 %	8.02 %
		<i>Spread-i në usd</i>
6-mujor	6.46 %	4.59 %
12-mujor	5.43 %	6.15 %
		<i>Spread-i në euro</i>
6-mujor	5.48 %	5.75 %
12-mujor	4.90 %	4.44 %

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Yield-et e bonove të thesarit.



Burimi: Banka e Shqipërisë

KURSI I KËMBIMIT

Prirja forcuese e lekut kundrejt dollarit amerikan u thellua më shumë gjatë muajit maj, ndërkohë që leku ishte i qëndrueshëm kundrejt euros. Forcimi i kursit të këmbimit lek/usd reflektoi zhvillimet në tregun valutor ndërkombëtar. Nga ana tjetër, stabiliteti i kursit të këmbimit lek/euro


Grafik 19. Ecuria e kursit nominal efektiv të këmbimit të lekut (NEER).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

reflektoi balancimin e presioneve dobësuese nga jashtë me presionet forcuese të tregut vendas. Në terma vjetorë, leku është forcuar kundrejt të dyja monedhave, dollarit amerikan dhe euros përkatësisht me 2.02 dhe 1.40 për qind. Në terma nominalë efektivë, leku është forcuar 1.5 për qind krahasuar me një vit më parë. Në fund të muajit maj, kursi i këmbimit shënonte 95.84 lek/usd dhe 123.3 lek/euro.

Grafik 20. Ndryshimet mesatare vjetore të kursit të këmbimit të lekut (- /forcim).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

SHËNIME

¹ Burimi: ISTAT; adresë e internetit: <http://www.istat.it>

² Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimeve Kombëtare Statistikore Greke; adresë e internetit: <http://www.statistics.gr>

³ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimeve Kombëtare Statistikore Greke; adresë e internetit: <http://www.statistics.gr>

⁴ Burimi: ISTAT; adresë interneti: <http://www.istat.it>

⁵ Të dhënat për muajin maj 2006 janë operative.

⁶ Shiko Shtojcën Statistikore për të dhëna të hollësishme.

⁷ Mesatarisht 10 miliardë lekë për periudhën prill-maj 2006.


⁸ Vlerat e grafikut tregojnë të dhënat më të fundit në tregun ndërbankar si dhe veçojnë disa nga vlerat maksimale në këtë treg.

⁹ Ky korridor u ndryshua në korrik të vitit 2005, nga asimetric (+250/-300 pikë përqindjeje) në simetrik (+175/-175 pikë përqindjeje).


¹⁰ Shiko tabelat në Shtojcën Statistikore.

SHTOJCË STATISTIKORE


Grafik 1. Treguesi i shitjeve reale (në vlerë absolute).



Grafik 2. Inflacioni vjetor (në përqindje).




Grafik 3. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje).




Grafik 4. Shpenzime fiskale kumulative dhe aktuale (në përqindje).




Grafik 5. Deficiti total dhe primar (në përqindje).




Grafik 6. Llogaria korente dhe deficiti tregtar në përqindje të PBB-së.



Grafik 7. Rritja vjetore e importeve dhe eksporteve (në përqindje).



Grafik 8. Bilanci mujor tregtar dhe llogaria korente (në miliardë usd).



INFLACIONI.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6	1.5
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8	
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.4	1.9

Burimi: INSTAT.

Tabelë 2. Kontributi në inflacionin total i grupeve përbërëse të shportës.

	nëntor 05	dhjetor 05	janar 06	shkurt 06	mars 06	prill 06	maj 06
Ushqime dhe pije joalkolike	0.09	-0.8	-0.16	-0.11	0.16	1.03	1.51
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	2.30	2.26	0.94	0.93	0.85	0.84	1.00
Transport	0.22	0.24	0.26	0.1	0.14	0.13	0.23
Hotele, kafe dhe restorant	0.21	0.21	0.21	0.19	0.20	0.22	0.22
Të tjera	0.13	0.15	0.14	0.10	0.11	0.12	0.10
Totali	2.94	2.06	1.39	1.33	1.48	2.35	3.10

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

AGREGATËT MONETARË.

Tabelë 3. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë).

	Prill 06 2005	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
		absolut	përqindje	absolut	përqindje
Paraja jashtë bankave	138.2	0.9	0.7	7.6	5.8
Depozitat totale	445.9	2.8	0.6	50.5	12.8
- në lekë	286.2	2.0	0.7	18.2	6.8
- në valutë	159.7	0.9	0.6	32.3	25.4
Depozita pa afat	131.7	1.1	0.8	43.3	49.0
- në lekë	80.8	0.7	0.9	38.7	92.0
- në valutë	50.9	0.4	0.8	4.6	9.9
Depozita me afat	314.2	1.7	0.6	7.2	2.3
- në lekë	205.4	1.3	0.6	-20.5	-9.1
- në valutë	108.8	0.5	0.4	27.7	34.2
M1	218.9	1.6	0.7	46.3	26.8
M2	424.3	2.9	0.7	25.8	6.5
M3	584.1	3.8	0.6	58.1	11.0
Baza monetare	190.6	4.3	2.3	16.5	9.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Ecuria e treguesve të MVN sipas grupeve kryesore (në milionë usd).

	Prill 06	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Mjete valutore neto	2146.6	44.3	141.4
Mjete valutore			
Banka e Shqipërisë	1,526.7	44.2	162.2
BPD	927.3	22.8	7.5
Deturime valutore			
Banka e Shqipërisë	106	1.9	-7.6
BPD	201.4	24.1	35.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve të Kredisë Neto për Qeverinë sipas grupeve kryesore.

	Prill 06	Ndryshime mujore	Ndryshime vjetore
Pretendime ndaj qeverisë neto	270.9	- 1.1	-8.4
Banka e Shqipërisë	53.1	-0.6	-3.2
BPD	217.8	-0.7	-5.2
Depozita pranë Bankës së Shqipërisë	5.3	- 1.3	0.4
Deficiti buxhetor	7.1	0.9	10.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

	2003	2004	T-1 '05	T-2 '05	T-3 '05	T-4 '05	T1-06	prill '06
Teprica e kredisë (në miliardë lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	121.9	134.6	140.0
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	34.1	33.7	31.6	32.8	31.9	32.1
Kredi afatmesme	33.3	36.0	34.5	33.1	31.2	30.3	30.3	29.7
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	31.4	33.1	36.9	37.0	37.8	38.2
Kredi për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.6	31.9	31.7
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.4	68.1	68.3
Lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	25.5	26.0	26.4
Valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	74.5	74.0	73.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Ecuria e kredisë për degët më kryesore të ekonomisë.

	2002	2003	2004	T1 '05	T2 '05	T3 '05	T4 '05	T1-06	prill '06
Bujqësia, Gjetia dhe Silvikultura	0.8	1	1.5	1.5	1.5	2.4	2.71	2.17	2.22
Industria përpunuese	17	17	17.1	16.7	15.6	13.9	16.8	14.22	13.30
Ndërtimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	12.8	13.78	13.02	12.95
Tregtia, riparimi i automobilitëve dhe artikujve shtëpiakë	0.4	34	23.3	20.6	19.1	20.0	15.9	18.99	19.76
Hotele dhe restorante	6	6	8.3	5.2	4.7	4.4	13.02	4.78	4.81
Pasuritë e patundshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.9	23.1	14.56	15.21
Të tjera	18.1	19	30.2	30.1	34.3	32.6	33.2	32.27	31.75
Totali	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Tregues të kredisë së re në përqindje ndaj totalit.

	Total 2004	2005				T1 '06	prill '06
		T1	T2	T3	T4		

Kredia e re (në miliardë lekë)	99.7	22.1	32.8	32.1	32.9	29.4	12.7
Kredi afatshkurtër	62.54	53.2	47	47.4	48.7	44.2	43.4
Kredi afatmesme	22.53	22.4	31	30.3	25.6	30.1	27.9
Kredi afatgjatë	14.93	24.4	22	22.2	25.7	25.7	28.7
Kredi në lekë	32.59	30.1	32.8	30.2	31.4	27.7	34.2
Kredi në valutë	67.41	70	67.2	69.8	68.6	72.3	66.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGJET FINANCIARE

Tabelë 9. Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme (në pikë përqindje).

	maj 06	Ndryshimi maj - prill 06	Ndryshimi maj 06 - maj 05
Norma bazë e interesit	5.00%	0.00	0.00
Tregu ndërbankar			
Interesi i tregut ndërbankar 1-ditor	4.60%	-0.04	2.27
Interesi i tregut ndërbankar 7- ditor	5.20%	-0.03	-0.12
Tregu primar			
yield-i i bono thesarit 3- mujore	5.07%	0.20	0.03
yield-i i bono thesarit 6- mujore	5.45%	-0.12	-0.99
yield-i i bono thesarit 12- mujore	5.72%	-0.11	-1.07
Tregu i obligacioneve			
yield-i i obligacioneve 2- vjeçare	6.30%	-0.20	-1.30

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 10. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave dhe të kredive në lekë (në pikë përqindjeje).

	prill 2006	Ndryshimi prill - mars 06	Ndryshimi prill 06 - prill 05
Norma bazë e interesit	5.00	0.00	0.00
Interesi i depozitave në lekë			
3 – mujore	3.30%	0.08	-0.26
6 –mujore	3.95%	-0.01	0.00
12 - mujore	4.60%	-0.20	-0.10
24- mujore	5.10%	-0.18	-0.12
Interesi i kredive në lekë			
Kredi deri në 6 muaj	11.97%	-1.56	-1.53
Kredi 6 muaj- 1 vit	13.12%	-0.74	-0.57
Kredi 1-3 vjet	16.52%	-0.74	-0.36
Kredi mbi 3 vjet	12.78%	0.25	0.43

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 11. Normat e interesit të depozitave në valutë (në pikë përqindjeje).

	prill 2006	Ndryshimi prill - mars 06	Ndryshimi prill 06 – prill 05
Fed-norma bazë e interesit	4.75%	0.00	+2.00
Interesi i depozitave në usd			
1 – mujore	2.46%	0.06	0.70

3 – mujore	2.91%	0.09	0.87
6 – mujore	3.34%	0.21	1.11
12 - mujore	3.74%	-0.18	1.02
24 - mujore	4.27%	-0.05	1.04
ECB-norma bazë e interesit	2.50%	+0.25	+0.50
Interesat e depozitave në euro			
1 – mujore	2.13%	0.18	0.46
3 – mujore	2.35%	0.02	0.63
6 - mujore	2.63%	0.24	0.87
12 - mujore	2.80%	0.06	0.78
24 - mujore	3.37%	0.15	0.42

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 12. Spread-i i normës së interesit depozitë - kredi në lekë dhe në valutë .

Spread-i interesit të depozitave:				
	lek-usd		lek-euro	
	prill 05	prill 06	prill 05	prill 06
3 – mujore	1.9%	1.0% ↓	2.2%	1.6% ↓
6 - mujore	2.5%	1.3% ↓	2.9%	2.0% ↓
12 -mujore	2.5%	1.4% ↓	3.2%	2.3% ↓
Spread-i i interesave të kredive:				
	prill 05	prill 06	prill 05	prill 06
6- mujore	5.7%	4.0% ↓	5.6%	3.6% ↓
6 mujore -1 vit	5.0%	3.2% ↓	5.6%	5.9% ↑
1-3 vjet	8.8%	6.8% ↓	8.5%	8.3% ↓
mbi 3 vjet	4.0%	2.7% ↓	4.3%	4.1% ↓

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 1,
JANAR 2006

1. Vendim nr.01, datë 25.01.2006 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.02, datë 25.01.2006 "Për miratimin e rregullores "Për ekspozimin e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë dhe administrimin e ruajtjen e tyre"". "
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 25.01.2006 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri sh.a."". "
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 25.01.2006 "Për caktimin e kontrollorëve të jashtëm për auditimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 2,
SHKURT 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.05, datë 08.02.2006 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"". "
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 08. 02. 2006 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri"". "
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.09, datë 08.02. 2006 "Për miratimin e dokumentit "Për misionin e Mbikëqyrjes"". "
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 08.02.2006 "Për prokurimin e drejtpërdrejtë të blerjes së karburantit, për nevoja të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 3,
SHKURT 2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 22.02.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin janar të vitit 2006"". "
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 22.02.2006 "Për miratimin e rregullores "Për nxjerrjen e akteve juridike"". "
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 22.02.2006 "Për një ndryshim në vendimin nr.79, datë 31.10.2005 të Këshillit Mbikëqyrës "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë"". "

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 4, MAJ
2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.19, datë 15.03.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit të Bankës së Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.20, datë 15.03.2006 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 15.03.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 12.04.2006 "Për një ndryshim në vendimin nr. 79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.31, datë 03.05.2006 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2006".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.32, datë 03.05.2006 "Për miratimin e rregullores "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë".
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.33, datë 03.05.2006 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 80 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Italo-Shqiptare sh.a., nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.p.a, Itali, tek Sanpaolo IMI S.p.A, Itali".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 8, NUMËR 5, MAJ
2006

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.37, datë 24.05.2006 "Për miratimin e "Raportit të politikës monetare për muajin prill të vitit 2006".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.38, datë 24.05.2006 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 60 për qind + 2 aksione të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., nga Kent Bank / Bayindir Bank A.S. tek Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim A.S., Turqi".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.40, datë 24.05.2006 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Statistikës të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.41, datë 24.05.2006 "Për "Prokurimin e drejtpërdrejtë" me kandidatin Kostare, për realizimin e shërbimit catering në Bankën e Shqipërisë".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 320 kopje